



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

PROCESVERBAL
KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, më 26.05.2021

Me datë 26.05.2021, ora 10.00, me kërkesën dhe nën drejtimin e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijojnë:

- 1. Miratimi i Logos së Gjykatës.*
- 2. Miratimi i formateve të rekursit që paraqitet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.*
- 3. Shpalljen e disa vende vakante.*
- 4. Të ndryshme.*

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

1. Sokol SADUSHI - Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë
1. Ilir PANDA - Anëtar Gjykatës së Lartë
2. Kelment GRECA - Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të pranishëm në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

Zj. A.V., me detyrë, Drejtore e Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë (Drejtore e Kabinetit të Kryetarit)

B.A., me detyrë, sekretare gjyqësore, e ngarkuar për të mbajtur dhe zbardhur procesverbalin audio të mbledhjes.

Në fjalën hyrëse, Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës, i cili pasi u miratua, vijoi me çeshtjet sipas rendit të ditës.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës që kishte të bënte me çeshtjen e logos së Gjykatës së Lartë, Zv/Kryetari i saj z. Sokol Sadushi sqaroi nevojën për ndryshimin e logos ekzistuese të Gjykatës së Lartë me nje logo të re si dhe përshkroi procesin nëpër të cilin kaloi dizenjimi i saj, me ndihmën e drejtpërdrejtë të projektit “Justice for All”, së bashku me formatin dhe karakteristikat që do të ketë.

Anëtarët e tjerë të Këshillit u shprehen dakord me variantin e logos së paraqitur për miratim, dhe në përfundim, Këshilli miratoi unanimisht logon e re të Gjykatës së Lartë.

Pika e dytë të rendit të ditës, ishte miratimi i formatit të rekursit që paraqitet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë sqaroi se, në kuadër të ndryshimeve të fundit në kodet procedurale, të cilat hyjnë në fuqi me datë 29 maj 2021, është parashikuar ndër të tjera, që Këshilli i Gjykatës miraton formatin e rekursit që palët duhet të paraqesin në Gjykatën e Lartë. Ky format do të orientojë në radhë të parë të gjithë praktikantët e së drejtës, në mënyrë të veçantë avokatët, por jo vetëm, që të kuptojnë se si duhet t’i drejtohen Gjykatës së Lartë. Ndonëse ky format, i cili përbën risi, nuk është me karakter detyrues por rekomandues, rekomandimi në këtë rast i mënyrës se si bëhet rekursi ka vlerën e vet, se përcakton në mënyrë të detajuar, atë që duhet të ketë një rekurs dhe konkretisht formati përmban bazën ligjore, paraqitjen e rrethanave të çështjes, shkaqet për të cilat kërkohet ndryshimi i tyre në përputhje me shkaqet që lejon ligji për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë (shkelje të ligjit procedural dhe material, me rëndësi për njehsimin apo ndryshimin të praktikës gjyqësore; shmangia nga praktika gjyqësore e Kolegjit përkatës apo të Kolegjeve të Bashkuara; shkelje të rënda procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimi) objektin e rekursit (pra çfare kërkohet ankuesit nga Gjykata).

Dy anëtarët e tjerë të Këshillit të Gjykatës, gjyqtari Ilir Panda dhe z. Kelment Greca u shprehen dakord me formatin e rekursit të propozuar, i cili në opinionin e tyre do të vlejë dhe do të shërbejë dhe në punën e ndihmësve ligjore dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë si dhe do të orientojë më mirë avokatët në paraqitjen e pretendimeve të tyre, duke sugjeruar që ky format të publikohet faqen zyrtare të Gjykatës, dhe t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të cilët ta shpërndajnë më pas te të gjitha dhomave të avokatëve të rretheve si dhe t’i dërgohet Shkollës së Magjistraturës dhe Shkollës së Avokatisë, rekomandime të cilat u pranuan dhe që do jenë pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit për formatin e rekursit.

Në përfundim, formati i rekursit i propozuar u miratua në unanimitet nga Këshilli i Gjykatës.

Pika e tretë të rendit të ditës, ishte shpallja e disa vendeve vakante në Gjykatën e Lartë. Referuar nevojave të Gjykatës së Lartë, Zv/Kryetari i saj z. Sokol Sadushi propozoi që për strukturën e Sekretarisë Gjyqësore të shpallen dy vende vakante, për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ndërsa për Qendrën e Dokumentacionit, si një strukturë e re, plotësimi i vendeve të bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, duke shpallur fillimisht vetëm dy vende vakante. Pra përfundimisht nga 4 (katër) vende, propozimi është 2 (dy) vende janë për Sekretarinë Gjyqësore dhe 2 (dy) janë për Qendrën e Dokumentacionit.

Anëtari i Këshillit gjyqtari z. Ilir Panda u shpreh dakord për plotësimin dhe shpalljen e vendeve vakantë për këtu struktura sipas propozimit. Por ai në kuadër rritjes së efikasitetit të punës së sekretarisë gjyqësore propozoi një mënyrë të ndryshme të organizimit të brendshëm të punës së sekretarisë gjyqësore, ku sipas këtij propozimi një sekretarë të atashohej dhe të vepronte për dy gjyqtarë, ç'ka do të sillte praktikisht shkurtim të kohës qoftë për komunikimin, qoftë për njoftimet, apo shpalljet, për organizimin e punës, për seancat publike që do të fillojnë tashmë të vijnë radhë me plotësimin gati 90% të Kolegjit Penal.

Anëtari tjetër i Këshillit z. Kelment Greca u shpreh dakord me shtesat dhe me publikimin e njoftimeve dhe hapjen e vendeve të lira.

Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë u shpreh se pa diskutim që do të ketë përsëri shtesa në vijimësi, por është e kuptueshme që të gjitha çështjet kanë të bëjnë me organizim të brendshëm të Gjykatës së Lartë, kanë nevojë për tu parë më shumë me vëmendje dhe për të gjetur zgjidhjen çdo lloj problematike që krijohet.

Në përfundim, anëtarët e Këshillit miratuan propozimin për plotësimin dhe shpalljen e dy vendeve vakante për Sekretarinë Gjyqësore dhe dy vende vakante për Qendrën e Dokumentimit.

Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, në pikën e fundit të rendit të ditës, “Të ndryshme”, paraqiti një propozim, i cili ishte në vetvete një propozim i të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Në mbledhjen e kaluar u krijuan trupat gjyqësore të kolegjeve përkatëse, duke bërë një ndarje të arsyeshme dhe pothuajse të barabartë të gjyqtarëve për shkak të profilit dhe të ngarkesës së tyre. Propozimi i gjyqtarëve të Kolegjit Penal, ka të bëjë me ngritjen e një trupë tjetër brenda tyre. Në përbërje të trupës së tretë gjyqësore propozohet që të jenë gjyqtarët Sokol Binaj, Sandër Simoni dhe Klodian Kurushi, e cila do të funksionojë me mirëkuptimin e tyre ditën e hënë.

Gjyqtari Ilir Panda, si Kryetari i Kolegjit Penal, theksoi se ishte dakord me propozimin për krijimin e një trupe të tretë në Kolegjin Penal, si dhe emrat e propozuara për në përbërjen e saj, por ngriti çështjen e kryesimit të kësaj trupe, duke propozuar gjyqtarin Sokol Binaj për këtë qëllim si gjyqtari me i vjetër në moshë dhe që vjen nga Gjykata e Apelit.

Propozimi lidhur me përbërjen e trupës së tretë si dhe me kryesimin e saj nga gjyqtari Sokol Binaj u miratua në mënyrë unanime nga Këshilli.